



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

# **KËNAQSHMËRIA E SPECIALIZANTËVE ME SHKOLLIMIN SPECIALISTIK**



- Ky pyetësor është realizuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me KOMS- Kosova's Organization of Medical Students për të vlerësuar kënaqshmërinë e specializantëve me shkollimin specialistik në QKUK.
- Pyetësi ka qenë anonim dhe pjesëmarrja në hulumtim nëpërmjet plotësimit të këtij pyetësit ishte vullnetare.
- **Qëllimi: *Kënaqshmëria e specializantëve të rinj me shkollimin specialistik.***

# Metodologjia




ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĚKARSKA KOMORA KOSOVA

- Ky hulumtim kishte për dizajn hulumtues metodat deskriptive, me zgjedhje të mostrës të randomizuar.
- Mostra u përcaktua përmes kalkulimit të numrit të personave reprezentues të target grupit, që në këtë hulumtim ishin specialistët e rinj. Numri i pjesëmarrësve u përcaktua për të dhënë rezultate signifikante me besueshmëri 95%, i cili ishte 256 pjesëmarrës (specializantë të rinjë).



# Rezultatet

- Nga mostra e përzgjedhur 53.9% (N=138) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 46.1% (N=118) të respondentëve janë të gjinisë mashkullore.




- Pjesa më e madhe e respondentëve kanë filluar specializimin në vitin 2020, të cilët përbëjnë 46.9% të pjesëmarrësëve, përcjellur nga specialistët e vitit 2021 me 39.8%. ( tab.1)

TABELA 1		Frekuenca	Perqindja
Valid	2016	8	3.1
	2017	20	7.8
	2018	4	1.6
	2019	2	0.8
	2020	120	46.9
	2021	102	39.8
	Total	256	100.0

- Mesatarisht respondentët tanë kanë pritur  $2.9\text{vite} \pm 1.2$  vite për të marrë specializimin nga diplomimin, me mode prej 2 vitesh dhe interval prej 1-14 vite.

# A i'u është prezentuar planprogrami i shkollimit specialistik para se të filloni specializimin?



■ PO ■ JO






- Vlera mesatare e kënaqshmërisë së specializantëve është **2.6**
- 34.4% prej tyre kanë vlerësuar që planprogrami nuk është përmbushur aspak që është edhe përgjigja më e shpeshtë
- 19.5% kanë vlerësuar që planprogrami është përmbushur plotësisht.

# A jane mbajtur ligjerata ne kuader te shkollimit specialistik



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĒKARSKA KOMORA KOSOVA




■ PO ■ JO



# A mbani konsultime me mentorin/en tuaj?



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĒKARSKA KOMORA KOSOVA



■ PO ■ JO



- Në pyetjen se *sa janë të kënaqur me angazhimin e mentorit/es të tyre gjatë shkollimit specialistik*, prej 1(aspak) deri në 5(shumë), specializantët mesatarisht e vlerësuan me **2.88**.
- **28.1%** prej tyre, pjesa më e madhe e kanë vlerësuar me 1 (Aspak) dhe **25.8%** me 5 (Shumë).
- Përgjigjen 1(aspak) më së shumti e kanë dhënë specializantët e gjinekologjisë dhe pediatriisë, ndërsa me përgjigjen 5(shumë) kryesisht janë përgjigjur specializantët e dermatologjisë dhe anesteziologjisë.

- Në pyetjen *se sa janë të kënaqur me realizimin e mësimit praktik gjatë shkollimit specialistik*, prej 1(aspak) deri në 5(shumë), specializantët mesatarisht e vlerësuan me **3.12**.
- **18.8%** prej tyre kanë vlerësuar me 1 (Aspak) dhe **25.8%**, pjesa më e madhe me 5 (Shumë).
- Me vlerën 1(aspak) kryesisht janë përgjigjur specializantët e dermatologjisë dhe pediatriisë, ndërsa me vlerën 5(shumë) janë përgjigjur më së shumti specializantët e anesteziologjisë dhe gjinekologjisë.


## Pyetja: Sa jeni të kënaqur me kushtet e punës gjatë shkollimit specialistik?

- **30.5%** prej tyre, pjesa më e madhe e kanë vlerësuar me 1 (Aspak) dhe **11.7%** me 5 (Shumë).
- Me përgjigjen 1(aspak) janë përgjigjur kryesisht specializantët e pediatriisë, dermatologjisë dhe kirurgjisë, ndërsa me 5(shumë) e kanë vlerësuar kryesisht specializantët e anesteziologjisë.

		Sa jeni të kënaqur me angazhimin e mentorit tuaj? (1- aspak, 5- shumë)	Sa jeni të kënaqur me realizimin e mësimit praktik në kuadër të shkollimit specialistik? (1- aspak, 5- shumë)	Sa jeni të kënaqur me kushtet e punës në repart/ klinikë? (1- aspak, 5- shumë)
<b>N</b>	<b>Valid</b>	<b>256</b>	<b>256</b>	<b>256</b>
	<b>Missing</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Mean</b>		<b>2.88</b>	<b>3.12</b>	<b>2.55</b>
<b>Median ( mesatarja)</b>		<b>3.00</b>	<b>3.00</b>	<b>2.00</b>
<b>Mode ( moda)</b>		<b>1</b>	<b>5</b>	<b>1</b>
<b>Std. Deviation ( devijimi standard)</b>		<b>1.542</b>	<b>1.442</b>	<b>1.359</b>



## Pika me e forte gjate shkollimit tuaj specialistik



■ Mesimi praktik   ■ Mesimi teorik   ■ Kushtet e punes   ■ Mentori/ja   ■ Tjeter


## Pyetja: Sa ndiheni të gatshëm të punoni të pavaruar nga mentori/ja juaj?

- 14.8% janë përgjigjur me 1(Aspak)
- 9.4% janë përgjigjur me 5(Shumë),

		Frekuenca	Perqindja
Valid	1	38	14.8
	2	40	15.6
	3	102	39.8
	4	52	20.3
	5	24	9.4
	Total	256	100.0

- Ndërsa pjesa më e madhe (39.8%) e kanë vlerësuar me 3 gatishmërinë e tyre për të punuar të pavarur nga mentori/ja e tyre.

A mendoni qđ ęshtę e nevojshme tę mbahet nję rotacion klinik jashtę vendit nę kuadęr tę shkollimit specialistik?



75% e respondentęve e kanę konsideruar qđ rotacioni klinik qđ rekomandohet tę mbahet jashtę vendit tę jetę mę i gjatę se tre muaj





# Perfundim

- Nga mostra e përzgjedhur 53.9% (N=138) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 46.1% (N=118) të respondentëve janë të gjinisë mashkullore.
- Pjesa më e madhe e respondentëve kanë filluar specializimin në vitin 2020, të cilët përbëjnë 46.9% të pjesëmarrësëve, përcjellur nga specialistët e vitit 2021 me 39.8%.
- Mesatarisht respondentët tanë kanë pritur  $2.9\text{vite} \pm 1.2$  vite për të marrë specializimin nga diplomimin.
- 53.1% i'u është prezentuar planprogrami i shkollimit specialistik para se të fillonin specializimin, ndërsa 46.9% nuk i'u është prezentuar ky planprogram,



# Perfundim

- 34.4% e specializantëve kanë vlerësuar që planprogrami nuk është përmbushur aspak dhe 19.5% kanë vlerësuar që planprogrami është përmbushur plotësisht.
- Në pyetjen se a janë mbajtur ligjërata në kuadër të shkollimit specialistik, 17.2% e respondentëve janë përgjigjur me PO, ndërsa 82.8% me JO.
- 49.6% e respondentëve janë përgjigjur se mbajnë konsultime me mentorin e tyre, ndërsa 50.4% janë përgjigjur me JO.
- Angazhimin e mentorit/es 28.1% e specializantëve, e kanë vlerësuar me 1 (Aspak) dhe 25.8% me 5 (Shumë).



# Perfundim

- Kënaqshmëri më të ulët me angazhimin e mentorit/es paten specializantët e gjinekologjisë dhe pediatriisë, ndërsa kënaqshmëri më të lartë kishin specializantët e dermatologjisë dhe anesteziologjisë.
- 18.8% e specializantëve nuk janë të kënaqur me mësimin praktik ndërsa 25.8%, pjesa më e madhe u shprehën se janë të kënaqur.
- Më pak të kënaqur me mësimin praktik dolën të jenë specializantët e dermatologjisë dhe pediatriisë, ndërsa më të kënaqur ishin specializantët e anesteziologjisë dhe gjinekologjisë.
- 30.5% e specializantëve , pjesa më e madhe nuk janë aspak të kënaqur me kushtet e punës ndërsa 11.7% janë shumë të kënaqur.



# Perfundim

- 64.1% e specializantëve vlerësuar mësimin praktik si pikën e tyre të forte, 13.3% kanë menduar se mësimi teorik është pika më e forte, 3.9% kanë vlerësuar kushtet e punës, dhe 7.8% janë përgjigjur se pika më e forte ka qenë mentori/ja e tyre, dhe 10.9% kanë thenë se të tjera elemente janë pika më të forta.
- 14.8% e specializantëve janë shprehur se nuk janë aspak të gatshëm të punojnë të pavarur nga mentori i tyre ndërsa 9.4% janë përgjigjur se janë shumë të gatshëm të punojnë të pavarur nga mentori i tyre.
- 97.7% e specializantëve konsiderojnë të nevojshme mbajtjen e një rotacioni klinik jashtë vendit në kuadër të shkollimit specialistik.
- 75% e respondentëve e kanë konsideruar që rotacioni klinik që rekomandohet të mbahet jashtë vendit të jetë më i gjatë se tre muaj

# Rekomandime



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĚKARSKA KOMORA KOSOVA

1. Hapja e specializimeve në raport me kërkesat e vendit për fusha të caktuara, dhe angazhimi i doktorëve të rinj në QMF apo Klinika deri në marrjen e specializimeve.
2. Të arrihet marrëveshja me Fakultetin e Mjekësisë për organizmin e ligjëratave në kuadër të shkollimit specialistik.
3. Fillimi i specializimeve të përputhet me fillimin e vitit akademik.
4. Të rritet llogaridhënia e mentorëve tek organet kompetente në lidhje me mbajtjen e ligjëratave dhe takimet e tyre me specializantët
5. Përditësimi i planprogramit të specializimeve në përputhje me planprogramet e reja bashkëkohore në botë.



# Rekomandime

7. Të shtohet numri i testimeve të specializantëve në përputhje me planprogramin në mënyrë që ai të përmbushet në tërësi.
8. Të evaluhohet kënaqshmëria e specilizantëve çdo vit.
9. Të avokohet për përmirësim të kushteve të punës.
10. Të mbahet mledhje me mentorët e klinikave me kënaqshmëri më të ulët të specializantëve.
11. Të shyrtohen mundësi të rotacioneve klinike jashtë vendit për së paku 6 muaj.